



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.924/2016**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.12.2016 shqyrtoi ankesën me: \_\_\_\_\_

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të KVO mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Arjan-A” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-49412-09-09-2016 me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pelet) për nevoja të Drejtorisë Spitalit Rajonal Dibër”, me fond limit 9 500 000 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 14.10.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.

**Ankimues:**

“IGMA” sh.p.k  
Buçimas, Fshati Starovë, Pogradec

**Autoriteti kontraktor:**

Drejtorja e Spitalit Rajonal Dibër  
Bulevardi “Elez Isufi”, Peshkopi

**Baza Ligjore:**

*Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore dhe shkallët e ankimimit të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 13.09.2016 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-49412-09-09-2016 me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pelet) për nevoja të Drejtorisë Spitalit Rajonal Dibër”, me fond limit 9.500.000 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 07.10.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Spitalit Rajonal Dibër.

II.2. Në datën 14.10.2016, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

“Europa”	nuk ka paraqitur ofertë	
“Arjan-A”	8.501.950,00 lekë	I kualifikuar
“Sulollari”	8.901.172,00 lekë	I skualifikuar
“IGMA”	9.481.522,50	I kualifikuar
“Nafire Molloholli”	9.490.763,75 lekë	I skualifikuar

II.4. Në datën 14.10.2016 operatori ekonomik “IGMA” sh.p.k. është njoftuar përmes sistemit të prokurimeve elektronike për klasifikimin e operatorëve ekonomikë.

II.5. Në datën 18.10.2016, operatori ekonomik ankimues “IGMA” sh.p.k., kundërshton vendimin e KVO-së, në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Arjan-A” sh.p.k në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

I. Në DST, në shtojcën 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 4 kërkohet:

“4. Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat vendore për vitin 2015 dhe periudhën e vitit 2016 në çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (Sipas QKR).”

Shoqëria Arjan-A sh.p.k ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2015 dhe 2016 vetëm për selinë e përcaktuar në QKB (Dibër, Peshkopi, Peshkopi Lagjia “Gjok Doçi), Rruga (Bulevardi) “Elez Isufi”, selia në katin e parë, ndërtesa me numër pasurie Nr. 5/340, Zona Kadastrale Nr. 2932, tek ish fabrika e makaronave Peshkopi), sipas vërtetimit lëshuar nga Bashkia Dibër, ndërsa për vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit nuk ka paguar detyrimet e taksave vendore duke qenë në kundërshtim me kriterin e përcaktuar në DST.

II. Në DST, në shtojcën 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kërkohet:

“Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që provon se ka realizuar furnizime të ngjashme, në një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë në një vlerë jo më pak se 40% te vlerës që prokurohet lekë (pa TVSH), të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit.
  - a) Kur furnizimi i së njëjtës natyrë është e realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate.
  - b) Kur furnizimi i së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturën/faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku të shënohen qartë datat, shumat dhe sasinë e mallrave të lëvruara.”

Në dokumentacionin e paraqitur në tender, shoqëria Arjan-A sh.p.k nuk ka paraqitur “furnizime të ngjashme, në një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë” duke mos plotësuar këtë kriter të vendosur në DST nga autoriteti kontraktor. Ky “Vërtetim” është kusht thelbësor për kualifikim të operatorit ekonomik pjesëmarrës në tender pasi vërteton që eksperiencia në kontrata të ngjashme është realizuar me korrektësi nga operatori ekonomik pjesëmarrës në tender.

III. Në DST, në shtojcën 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kërkohet:

“2. Operatori ekonomik duhet të disponojë një automjet të përshtatshëm për transportin e lëndës djegëse, në pronesi ose me kontratë qeraje me akt noterial, shoqëruar me dokumentet si: leje qarkullimi, siguracionet, taksat e mjetit, kontrolli i mjetit (kolaudimi).

3. Të ketë gjendje 3 (tre) copë kaldaja me pelet (me fuqi 480 – 500 KW) me këto të dhëna:

○ Tipi	350/440
○ Fuqia min/max e punës	392 - 530 kw
○ Fuqia termike nominale	500 kw
○ Fuqia termike e kthyer	459 kw
○ Tensioni i punës (elektrik)	380 v
○ Fuqia motorrike	1100 W
○ Rendimenti	87 %
○ Presioni i ujit	1,5 - 3,8 bar
○ Lartësia	2750 mm
○ Gjatësia	2180 mm
○ Gjerësia	1720 mm
○ Pesha	1855 kg
○ Kapaciteti i ditor i silozit	1,5 m <sup>3</sup>

4. Të ketë gjendje 3 ( tre ) bruciator me pelet me këto karakteristika teknike:

○ modeli	BP 500 kw
○ fuqia min/max në kw	400-550 kw
○ tensioni i punës (elektrik)	220 V
○ fuqia e motorit të ventilatorit	190 W
○ Kandelet e ndezjes 2 copë	750 W
○ Rendimenti	85 %
○ dimensionet	360 x 420 x 1200 mm
○ shneku me diameter	110 mm
○ fuqia e motorit të shnekut	180 W
○ dimensioni tubit të shkarkimit	75 mm

5. Operatori ekonomik që kualifikohet duhet ti ketë të montuara paisjet djegëse të peletit nga data e fillimit të kontratës deri në përfundimin e saj.

6. Paisjet teknike (kaldajat dhe djegësat/bruciatorët) duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose në kontrata qeraje noteriale.

7. Për të vërtetuar këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë akt çdoganimi ose kontratë shitblerje noteriale.

8. Për paisjet teknike të marra me qera duhet të paraqitet kontratë qeraje noteriale e shoqëruar me dokumentin e pronësisë së qiradhënësit (akt çdoganimi ose kontratë shitblerje).

9. Autoriteti kontraktor, ka të drejtën të kryejë verifikimin fizik të kaldajave dhe djegësave (bruciatorët), me ose pa lajmërim paraprak, përpara vlerësimin të ofertave nga KVO.

10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë si dhe të përcaktojë saktë vendndodhjen e pajisjeve teknike, të cilat duhet të jenë brenda teritorit të Republikës së Shqipërisë.

11. Ofertuesit duhet të paraqesin deklaratë nga administratori i shoqërisë që kaldajat dhe djegësat (bruciatorët) e propozuar, nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë tjetër.”

Shoqëria “Arjan-A” sh.p.k për të plotësuar këtë kriter të DST ka paraqitur në tender “deklaratë”, në të cilën ky operator ekonomik merr përsipër që në rast se fiton tenderin do të sigurojë/montojë pajisjet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës.

*Kjo deklaratë e paraqitur në tender nga shoqëria “Arjan-A” sh.p.k nuk plotëson kriterin e vendosur në DST. Është rast i paprecedentë që operatori ekonomik të kualifikohet në tender me deklaratë të tipit “po fitova tenderi”, do ti marr më vonë/do ti montoj/do ti siguroj, pajisjet teknike....”*

*I kërkojmë KVO, pse nuk kemi bërë verifikim fizik të pajisjeve teknike për operatorët ekonomik që kemi kualifikuar?*

II.5. Në datën 24.10.2016 me anë të shkresës nr.594/1 prot autoriteti kontraktor e ka venë në dijeni ankimuesin në lidhje me pretendimet e parashtuara në ankesë duke vendosur refuzimin e ankesës.

II.6. Në datën 03.11.2016 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 09.11.2016, nëpërmjet shkresës me nr.619/1 prot., protokolluar me tonën me nr. 2249/2 prot, datë 11.11.2016 me objekt: “Informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “IGMA” sh.p.k për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Arjan-A” sh.p.k me arsyetimin se: “*Shoqëria Arjan-A sh.p.k ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2015 dhe 2016 vetëm për selinë e përcaktuar në QKB (Dibër, Peshkopi, Peshkopi Lagjia “Gjok Doçi), Rruga (Bulevardi) “Elez Isufi”, selia në katin e parë, ndërtesa me numër pasurie Nr. 5/340, Zona Kadastrale Nr. 2932, tek ish fabrika e makarobnave Peshkopi), sipas vërtetimit lëshuar nga Bashkia Dibër, ndërsa për vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit nuk ka paguar detyrimet e taksave vendore duke qenë në kundërshtim me kriterin e përcaktuar në DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në Shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 4 rezulton se nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

*“Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat vendore për vitin 2015 dhe periudhën e vitit 2016 në çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (Sipas QKR)”*

III.1.2. Nga verifikimet, në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Ekstrakt i regjistrit tregëtar dhe Ekstrakt Historik i regjistrit tregëtar i shoqërisë “Arjan-A” sh.p.k, lëshuar në datë 26.09.2016;*

- Vërtetim për likuidimin e detyrimeve për taksat vendore për vitin 2015, lëshuar nga Bashkia Dibër datë 06.10.2016;
- Vërtetim për likuidimin e detyrimeve për taksat vendore për vitin 2016, lëshuar nga Bashkia Dibër datë 27.09.2016;
- Njoftim detyrimi për vitin 2015, nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë;
- Faturë për arkëtim Nr. 20891 datë 15.10.2015 nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë;
- Njoftim detyrimi për vitin 2016, nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë;
- Faturë për arkëtim Nr. 26127 datë 04.10.2016 nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Neni 12 “Rregjistrimi dhe Liçensimi” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit sa më sipër, si dhe verifikimit të të dhënave të subjektit në Ekstraktin Historik të QKR konstaton se zyra qendrore e shoqërisë “Arjan-A” sh.p.k është Dibër, Peshkopi ndërsa në seksionin 13 “Vënde të tjera të ushtrimit të aktivitetit” të Ekstraktit Historik të QKR, rezulton se operatori ekonomik ankimues ushtron aktivitetet përkatësisht edhe në Tiranë.

Komisioni konstaton se operatori ekonomik “Arjani-A” sh.p.k nuk ka paraqitur vërtetim lëshuar nga Bashkia Tiranë lidhur me pagesën e taksave vendore por ka paraqitur “Njoftim detyrimi” dhe disa Fatura arkëtimi të cilat nuk janë të njëvlefshme me vërtimin që duhet të ishte lëshuar nga strukturat vendore.

Dokumenti “Njoftim Detyrimi” i Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë, konstatohet se është një format letër i printuar nga sistemi (pa datë, numër protokolli, firmë dhe vulë) që nuk përmban elementët e një shkrese zyrtare lëshuar nga një organ i administratës publike (në rastin konkret organ i pushtetit vendor), aq më tepër nuk është një dokument i lëshuar në formatin vërtetim siç është kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.



Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet, përvojën e duhur, personel, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik nuk ka paraqitur një dokument të lëshuar nga autoritetet lokale për pagimin e taksave vendore, mbi bazën e të cilit autoriteti kontraktor të gjykojë nëse është në përputhje me kërkesat e përcaktuara.

Sqarojmë se dokumenti i cili provon shlyerjen e detyrimeve vendore është vërtetimi i lëshuar nga njësi vendore ku operatorët ekonomikë kanë selinë e tyre dhe me të drejtë është përcaktuar nga autoriteti kontraktor në kriteret kualifikuese. Për rrjedhojë faturat e arkëtimit të paraqitura nga operatori ekonomik nuk provojnë nëse janë paguar të gjitha taksat vendore, si në llojin e tyre ashtu edhe në vlerë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "IGMA" sh.p.k qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "IGMA" sh.p.k. mbi kualifikimin e shoqërisë "Arjan-A" sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipërm në pikën III.1.5., gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik "Arjan-A" sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "IGMA" sh.p.k për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur" me Nr. REF-49412-09-09-2016 me objekt: "Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pelet) për nevoja të Drejtorisë Spitalit Rajonal Dibër", me fond limit 9 500 000 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 14.10.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.
2. Autoriteti kontraktor të anullovë vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik "Arjan-A" sh.p.k duke e skualifikuar atë nga procedura e prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "IGMA" sh.p.k

4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 2249 Protokolli; Datë 03.11.2016**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Spiro Kuro**

**Anëtar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**

